



**RAPORTI VJETOR**  
**I**  
**INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË**  
**PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**  
**VITI 2019**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>1. KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI</b> .....	<b>5</b>
<b>1.1 ZBATIMI I LIGJIT NR. 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE LEGJISLACIONIT PËR SISTEMIN E RI TË DREJTËSISË</b> .....	<b>5</b>
<b>1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”</b> .....	<b>8</b>
<b>1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË</b> .....	<b>17</b>
<b>2. TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË</b> .....	<b>19</b>
<b>2.1. ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE</b> .....	<b>19</b>
<b>2.2. SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK</b> .....	<b>20</b>
<b>2.3. KONTROLLI I PLOTË</b> .....	<b>20</b>
<b>2.4. REZULTATET E KONTROLLIT</b> .....	<b>20</b>
<b>3. ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES</b> .....	<b>21</b>
<b>4. BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>22</b>
<b>4.1. BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I BRENDSHËM</b> .....	<b>22</b>
<b>4.2. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË</b> .....	<b>23</b>
<b>5. TRANSPARENCA INSTITUCIONALE</b> .....	<b>24</b>
<b>6. PERFORMANCA FINANCIARE</b> .....	<b>25</b>
<b>7. PËRMbledhje e arritjeve</b> .....	<b>27</b>
<b>8. PRIORITET PËR VITIN 2020</b> .....	<b>29</b>
<b>ANEKSI NR. 1</b> .....	<b>30</b>

## HYRJE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përgjatë vitit raportues, ka ushtruar kompetencat institucionale duke pasur në fokus të veçantë rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2019, si dhe duke punuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative dhe investiguese, duke qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit, si faktorë që ndikojnë në arritjen e rezultateve konkrete në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kuadër, Inspektori i Përgjithshëm, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 39, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, në Raportin Vjetor të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, paraqet masat e ndërmarra për përmbushjen e prioriteteve dhe angazhimeve institucionale, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është një dokument gjithëpërfshirës i punës dhe aktiviteteve institucionale; i problematikave dhe rezultateve të arritura në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi; masave konkrete të marra në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe të forcimit të shtetit ligjor, bashkëpunimit ndër-institucional e ndërkombëtar, si dhe të transparencës së realizuar me publikun, median, shoqërinë civile, organizmat ndërkombëtare dhe institucionet homologe në rajon.

Gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë vijoi të mbështesë procesin reformues të sistemit të drejtësisë, si një masë e domosdoshme dhe emergjente për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, si dhe për të garantuar konsolidimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, me pjesën më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndër-institucional me organet e rivlerësimit kalimtar (vetting-ut) u forcua më tej, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale në mënyrë sa më efektive, brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe akteve ligjore në fuqi, të lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kështu, në bashkëpunim të ngushtë me organet e rivlerësimit, përkatësisht me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), si dhe bazuar në listat e subjekteve të rivlerësimit dërguar nga këto organe dhe afatet e përcaktuara prej tyre, ka përfunduar verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura në deklaratat e pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së deklaruar, si dhe situatave të mundshme të konfliktit të interesave, brenda afateve ligjore.

Konkretisht, u përfundua dhe dorëzua pranë këtyre organeve, dokumentacioni i plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, për pjesën e mbetur të gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe prokurorëve pranë prokurorive të apelit, si dhe për një pjesë të

gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë, për periudhën e raportimit, ka vijuar me zbatimin me korrektësi të tre ligjeve bazë, respektivisht Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, duke pasur veçanërisht në fokus përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në Rezolutën për vitin 2019.

Në këtë drejtim, për t’u theksuar është angazhimi i gjerë institucional në rritjen e kapaciteteve të Autoriteteve Përgjegjëse për zbatimin e Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe Njësive Përgjegjëse për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, si në sektorin publik dhe në atë privat. Gjatë vitit raportues, Autoritetet dhe Njësitë Përgjegjëse u përfshinë në një sërë sesionesh dhe aktiviteteve trajnuese/informuese për njohjen dhe zbatimin me përgjegjshmëri më të lartë, të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor.

Përsa i përket performancës institucionale gjatë vitit 2019, krahas paraqitjes në mënyrë të detajuar të Raportit Vjetor, në vijim të arritjeve dhe prioriteteve, Inspektorati i Lartë dëshiron të ritheksojë angazhimin në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese e ligjore, lidhur me përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, verifikimit të kandidatëve për organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, forcimit të mëtejshëm të rolit institucional në kontrollin e deklarin të interesave privatë, parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe në hetimin e rasteve të sinjalizimit e garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

## 1. KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI

### 1.1 ZBATIMI I LIGJIT NR. 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE LEGJISLACIONIT PËR SISTEMIN E RI TË DREJTËSISË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), përgjatë vitit raportues, ka punuar në drejtim të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë të parashikuar në Rezolutën për vitin 2019, duke vazhduar me vendosmëri *“Procesin e dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para”*.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka vijuar të ketë prioritet të punës së tij procesin e reformimit të sistemit gjyqësor, duke garantuar vazhdueshmërinë e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve/ndihmësve ligjorë të të gjitha niveleve (Vetting), si dhe të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, nëpërmjet angazhimit të pjesës më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale.

Inspektorati i Lartë, përgjatë vitit raportues, vijoi procesin e përpunimit të të dhënave të ardhura nga korrespondenca e gjerë shkresore, e dërguar fillimisht nga rreth 26 institucione juridike publike dhe private, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ASHK, QKB, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSSHE, etj), por që u shtua më tej, në varësi të ecurisë së procesit të kontrollit dhe nevojës për të marrë informacione shtesë pranë institucioneve juridike publike dhe private të tjera.

Në këtë kuadër, ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me organet e rivlerësimit, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) ka qenë tërësisht i angazhuar në përfundimin brenda afateve ligjore të proceseve të kontrollit të deklaratave të pasurive të subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në listat e dërguara prej tyre, sipas afateve të përcaktuara.

Konkretisht ka përfunduar dhe dorëzuar pranë këtyre organeve, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe prokurorëve pranë prokurorive të apelit, si dhe ka vijuar procesin për gjyqtarët dhe prokurorët, përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para, **për periudhën janar - dhjetor 2019, në total për 220 subjekte të procesit të rivlerësimit**. Ky numër, së bashku me subjektet e përfshira për periudhën **janar - dhjetor 2018**, si dhe listën prioritare, të dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës **nëntor - dhjetor 2017**, shkon në total në **715 subjekte të procesit të rivlerësimit**.

Për sa më sipër, ILDKPKI mbetet i angazhuar për të vijuar mbështetjen e procesit edhe përgjatë vitit 2020, në përmbushjen e detyrimeve të tij kushtetuese e ligjore, me qëllim përmbylljen me sukses të procesit të dorëzimit të raporteve përfundimtare, së bashku me dosjet respektive për të gjithë subjektet e rivlerësimit, pranë organeve të rivlerësimit dhe ONM.

Përveç kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ILDKPKI në zbatim të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, përgjatë periudhës raportuese ka administruar deklaratat e pasurisë së subjekteve kandidatë për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ka ushtruar kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare nga subjektet kandidatë dhe personave të lidhur me ta.

Në kuadër të detyrimeve ligjore, si dhe bashkëpunimin me organet e emërtesës, përgjatë vitit 2019 është ushtruar kontrolli i plotë për deklaratat e interesave privatë për rreth **135 kandidatë** në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, duke realizuar:

- ✚ Në zbatim të Ligjit, nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, përfundimin e kontrollit të plotë për **4 kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dosjeve origjinale të kontrollit të plotë për secilin kandidat, ku u përfshinë Deklaratat e Interesave Privatë të kandidatit, dokumentacioni i administruar nga korrespondenca me institucionet e specializuara, raporti përfundimtar i kontrollit së bashku me konkluzionet përkatëse;
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për **30 kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë** dhe dërgimin pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dosjen origjinale të kontrollit të plotë për secilin kandidat, e cila përmban Deklaratat e Interesave Privatë të kandidatit, dokumentacionin e dorëzuar nga vetë subjekti, dokumentacionin e administruar nga korrespondenca me institucionet e specializuara, raportin përfundimtar të kontrollit, së bashku me konkluzionet përkatëse;

Në rastet kur kandidatët kanë qenë apo vazhdojnë të jenë subjekte të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në dosje janë dërguar edhe deklaratat e interesave privatë ndër vite.

Nëse kandidatët kanë qenë edhe subjekte të Ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pjesë e dosjes ka qenë edhe akti i kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë së Rivlerësimit, (Vetting), me konkluzionet përkatëse, si dhe vendimi i marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, **për 8 kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë**, nga rradhët e juristëve të spikatur, të kualifikuar pas procesit përzgjedhës dhe i vendosi në dispozicion Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktet e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë;
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë **për 10 kandidatë për magjistratë (profili gjyqtar)**, të diplomuar në periudhën korrik 2018, **për 15 kandidatë magjistratë**, të diplomuar në vitin 2019, si dhe për **28 kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në profilin gjyqtar**. Në përfundim të kontrollit të plotë ILDKPKI, për të **53 kandidatët (profili gjyqtar)** i vendosi në dispozicion Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktet e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 6 kandidatë për magjistratë (profili prokuror)**, të diplomuar në periudhën korrik 2018, për **10 kandidatë magjistratë të diplomuar në vitin 2019**, në pritje për emërim dhe për **24 kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në profilin prokuror**. Në përfundim të kontrollit të plotë ILDKPKI për të **40 kandidatët (profili prokuror)** vendosi në dispozicion të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, aktet e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.

Për më tepër, në kuadër të proceseve reformuese, Inspektorati i Lartë, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i njohur dhe si Vettingu në Polici, në zbatim të nenit 9 pika 2, në të cilin parashikohet se “...5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të përzgjedhur ndërmjet punonjësve të këtij institucioni, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ky organ cakton, gjithashtu, edhe 2 anëtarë zëvendësues, të cilët zëvendësojnë anëtarët që mungojnë..” ka përzgjedhur dhe emëruar 5 Inspektorë pranë këtyre organeve. Inspektorët e ILDKPKI do të jenë tërësisht të angazhuar pranë organeve të vetting-ut, për të dhënë ekspertizën dhe

eksperiencën e tyre gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve të parashikuar nga ligji, kryesisht në komponentin e vlerësimit të pasurisë.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2019, me qëllim mbështetjen e procesit të vlerësimit kalimtar për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, bazuar në kërkesat e dërguara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i janë vënë në dispozicion këtij Komisioni, deklaratat e interesave privatë, së bashku me materialet shoqëruese, për drejtuesit e nivelit të lartë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës së Shqipërisë.

## 1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përgjatë vitit raportues, vijoi zbatimin e kompetencave të dhëna me anë të Ligjit nr. 60, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në kuadër edhe të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2019 “*Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjitha palëve në proces, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.*

Në zbatim të ligjit, ILDKPKI, përveç funksionimit si mekanizëm i jashtëm raportimi, ngarkohet: të monitorojë dhe të nxjerrë udhëzime për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm; të kontrollojë funksionimin e duhur të mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm të njësive përgjegjëse të organizatave; të konstatojë kundravajtjet administrative sipas këtij ligji dhe të vendosë gjopa në përputhje me nenin 23 të këtij ligji; të marrë dhe të hetojë kërkesat për mbrojtje ndaj masave hakmarrëse kundër sinjalizuesve dhe të garantojë mbrojtjen e sinjalizuesve nga masat hakmarrëse; mbi bazën e raporteve vjetore të Njësive Përgjegjëse, të hartojë vlerësime dhe të japë rekomandime për zbatimin e këtij ligji; të ofrojë këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve; të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, ILDKPKI përgjatë vitit raportues mbajti kontakte të vazhdueshme me Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik dhe privat, duke administruar dhe analizuar raportimet e dërguara prej tyre, si dhe duke bërë përditësimet e nevojshme në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike dhe në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në sektorin privat. Nga të dhënat statistikore, rezultoi se në total janë ngritur dhe funksionojnë **168 njësi përgjegjëse** në sektorin publik, si dhe **444 njësi përgjegjëse** në sektorin privat.

Në fokus të veçantë, përgjatë vitit raportues, ka vijuar të jetë rritja e kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse, si në sektorin publik dhe atë privat, ku me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë u arrit të realizoheshin një sërë aktiviteteve informuese dhe trajnuese.

Kështu, ILDKPKI me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, projekt ndërmjet Austrisë,



Gjermanisë dhe Shqipërisë, i financuar nga BE, bazuar mbi kurrikulën trajnuese të rishikuar dhe kalendarit të dakordësuar me ASPA, në tremujorin e parë të vitit 2019, zhvilloi **14 sesione trajnuese** pranë ASPA, për Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik, si në nivel qendror dhe atë vendor, me pjesëmarrjen e **217 anëtarëve nga Njësitë Përgjegjëse**.

Gjithashtu, në bashkëpunim të ngushtë me OSBE, përgjatë vitit raportues, mori të gjitha masat për organizimin me sukses të disa sesioneve trajnuese për Njësitë Përgjegjëse në sektorin privat, të cilat synonin:

- Të rrisnin ndërgjegjësimin e Njësive Përgjegjëse për sinjalizimin, lidhur me kuadrin ligjor në fuqi;
- Të trajnonin Njësitë Përgjegjëse për sinjalizimin mbi të drejtat, detyrimet e tyre lidhur me procesin e sinjalizimit, procedurat dhe politikat e brendshme për trajtimin e rasteve të sinjalizimit;
- Të paraqisnin praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me trajtimin e rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës **18 - 28 qershor 2019**, sipas një kalendarit të dakordësuar më parë, midis Inspektoratit të Lartë dhe OSBE, u zhvilluan **8 seminare trajnuese**, ku morën pjesë dhe u trajnuan **95 anëtarë nga Njësitë Përgjegjëse**.

Seminaret trajnuese u organizuan dhe u zhvilluan të ndara në 2 sesione:

- 1) Sesioni i parë, në të cilin u përfshinë disa nga konceptet bazë dhe kryesore të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve;
- 2) Sesioni i dytë, në të cilin u ndanë disa sugjerime konkrete me pjesëmarrësit mbi mënyrat e zbatimit të programeve mbi sinjalizimin/speak up apo anti-korrupsion.

Gjatë periudhës **shtator - tetor 2019**, në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH), si partner zbatues i projektit “*Mbi zbatimin e legjislacionit të sinjalizimit*”, të financuar nga Ambasada e SHBA-ve Tiranë, ka siguruar kontributin e tij në mbarëvajtjen e seancave informuese që u organizuan me Njësitë Përgjegjëse dhe punonjësit e tjerë në 10 ministri të linjës. Në këto sesione morën pjesë dhe u informuan për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, **213 nëpunës** të Njësive Përgjegjëse dhe nëpunës të tjerë pranë ministrive përkatëse.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22 të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, brenda datës 15 janar 2020 ka prituri dhe administruar raportet vjetore të dërguara nga Njësitë Përgjegjëse, si nga autoritetet publike dhe organizatat private.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka marrë dhe administruar 147 raporte vjetore nga Njësitë Përgjegjëse pranë autoriteteve publike, ku nga analizimi i tyre konstatohet se në 2 Njësi Përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar raste në kuadër të Ligjit nr. 60/2016.

Në lidhje me Njësitë Përgjegjëse pranë sektorit privat janë marrë dhe janë administruar 244 raporte, ku nga analizimi i tyre konstatohet se në 1 Njësi Përgjegjëse janë paraqitur dhe trajtuar sinjalizime në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 60/2016.

Gjithashtu, gjatë vitit raportues, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, Inspektorati i Lartë ka regjistruar dhe trajtuar në total **14 raste sinjalizimi dhe 1 kërkesë** për mbrojtje nga hakmarrja të ardhur nga sektori publik.

ILDKPKI ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, si dhe për të zhvilluar hetime administrative në respektim të afateve ligjore, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 60/2016 dhe K.Pr. Administrative.

Për rastet e sinjalizuara, pas kryerjes së hetimeve administrative, janë vënë në dijeni edhe organet kompetente sipas problematikave të ngritura nga sinjalizuesit, si vijon:

- ✚ -Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- ✚ -Njoftim për ndjekje penale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- ✚ -Njoftim Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- ✚ -Njoftim Titullarit të Autoritetit Publik Qendror, për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Lidhur me kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja, pas regjistrimit në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, është kryer hetimi administrativ në përputhje me afatet ligjore të parashikuara nga dispozitat e Ligjit nr. 60/2016 dhe K.Pr. Administrative.

Për më tepër, janë marrë masat e nevojshme në kuadër të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në Rezolutën për vitin 2019, ku parashikohet ***“Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës mbi ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, për zgjidhjen e problematikave të evidentuara deri më tani, si dhe të informojë Kuvendin për gjetjet e këtij vlerësimi”***.

Në këtë kuadër, përgjatë vitit raportues Inspektorati i Lartë ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) për zbatimin e projektit *“Për një zbatim më të mirë të legjislatcionit për sinjalizimin në Shqipëri”*, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla, i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë, si dhe me Prezencën e OSBE në Shqipëri në dhënien e mbështetjes financiare në kryerjen e një vlerësimi paraprak të jashtëm nga një ekspert i pavarur, për ligjin për sinjalizimin.

KSHH, në përfundim të analizimit të kuadrit ligjor, si dhe diskutimeve e vështirësive të paraqitura nga Njësitë Përgjegjëse gjatë sesioneve trajnuese, në raportin përfundimtar për zbatimin e ligjit, kryesisht në ministritë e linjës, nga shkaqet kryesore lidhur me mungesën e rasteve të sinjalizimit, ka evidentuar:

- Mekanizmat e sinjalizimit dhe mbrojtja që duhet t'i ofrohet sinjalizuesve nuk janë bërë të njohura në shkallë të gjerë tek punonjësit, si dhe tek Njësitë Përgjegjëse. Disa punonjës pohojnë se mund të dinë të dhëna të ndryshme rreth akteve me natyrë korruptive, por nuk

disponojnë fakte dhe prova, të cilat janë të rëndësishme për të rezultuar në një sinjalizim të bazuar.

- Mungesa e besimit, se sinjalizimi do të merret dhe trajtohet me profesionalitet, paanshmëri dhe pavarësi. Në radhët e punonjësve ekziston perceptimi se në shqyrtimin e sinjalizimeve do të ketë ndërhyrje të paligjshme.
- Frika nga hakmarrja e punëdhënësve. Pavarësisht garancive ligjore, punonjësit ndihen të pasigurtë lidhur me masat që mund të merren në mënyrë të fshehtë (kamufeluar) ndaj tyre.
- Ekzistenca e platformave të tjera të raportimit/ankimit, ku mund të adresohen dyshimet lidhur me rastet e dyshuara të korrupsionit, si psh. Platforma e Bashkëqeverisjes, ku mund të paraqiten ankesa direkt si qytetarë, duke mos përmbushur kushtin e ekzistencës së marrëdhënies së punës, si në rastin e sinjalizimit.
- Sinjalizimi është një koncept i ri për shoqërinë shqiptare dhe shpeshherë bëhet një krahasim analog i gabuar me të shkuarën, ku rastet e sinjalizimit trajtohen me nënkuptime negative si “spiunim”.

Në rekomandimet e dhëna nga KSHH<sup>1</sup> lidhur me përmirësimin e zbatimit të kuadrit ligjor për sinjalizimin, kryesisht evidentohet nevoja për:

1. Forcimin e mëtejshëm të angazhimit të ILDKPKI për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 60/2016, për ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes ndaj Njësive Përgjegjëse të ministrive, sa i takon zbatimit të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, nëpërmjet udhëzimeve, rritjes së kapaciteteve të anëtarëve, si dhe monitorimit të veprimtarisë së tyre. Angazhimin në bashkëpunim me Njësitë Përgjegjëse për ndërgjegjësimin dhe njohjen e një numri më të gjerë punonjësish lidhur me Ligjin nr. 60/2016 (nëpërmjet sesioneve informuese, trajnimeve etj).
2. Marrjen e masave për rishikimin e përkrahjeve të punës të nëpunësve që janë pjesë e Njësive Përgjegjëse, duke përshtatur për pasojë edhe pagat në varësi të angazhimeve dhe detyrave që ata duhet të përmbushin (për shembull nga niveli III.b në nivel III.a). Trajtimi i përshtatshëm financiar i nëpunësve të Njësive Përgjegjëse, vlerësohet se i shërben rritjes së përgjegjshmërisë, pavarësisë dhe efikasitetit të tyre në zbatimin e Ligjit nr. 60/2016.
3. KSHH, duke marrë në konsideratë mungesën e besimit të anëtarëve të Njësive Përgjegjëse, si një arsye për mungesën e sinjalizimeve, rekomandon, se për emërimin, zëvendësimin apo caktimin e anëtarëve të Njësive Përgjegjëse, titullarët e institucioneve, veç kritereve të përcaktuara në VKM nr. 816, datë 16.11.2019, duhet të mbajnë në vëmendje edhe vlerësimet e vazhdueshme të punonjësve, të cilët kanë treguar integritet dhe profesionalizëm, për t'i angazhuar ata si pjesë të Njësive Përgjegjëse.
4. Njësitë Përgjegjëse të ministrive të monitoruara, duhet të raportojnë pranë ILDKPKI, në mënyrë më të plotë për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, për pengesat dhe vështirësitë e hasura dhe nevojat që ato kanë në drejtim të zbatimit më të mirë të këtij ligji. Për këto raporte, rekomandohet të respektohet në çdo rast afati i përcaktuar në ligj, me qëllim shmangien e vështirësive praktike në administrimin e raporteve nga ILDKPKI.

<sup>1</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi\\_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri\\_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf)

5. Për Njësitë Përgjegjëse vlen rekomandimi për zbatimin me përpikmëri të dispozitave lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të Ligjit nr. 60/2016 dhe Udhëzimit nr. 44, datë 31.8.2016, “Për kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Kuvendi mund rrisë mbikëqyrjen e posaçme parlamentare për zbatimin e ligjit, si dhe mund të ndikojë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit, rishikimit të dispozitave, që të mundësojë mbrojtjen e sinjalizuesve që sinjalizojnë në publik, shpërblimin e sinjalizuesve, suprimimin ose në të kundërt fuqizimin e mekanizmave ku bëhen sinjalizimet, etj.
7. Orientimin e drejtë të ILDKPKI dhe Njësitë Përgjegjëse të 11 ministrive, për të pranuar rastet e sinjalizimeve anonime, konform dispozitave të Ligjit nr. 60/2016 dhe në mënyrë të veçantë nenit 7, pika 2 të tij. KSHH vlerëson se sinjalizimi anonim, i parashikuar në ligj, merr në konsideratë nevojën se mosnjohja e identitetit të sinjalizuesit do të nxisë nëpunësit që të sinjalizojnë veprimet apo praktikat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.
8. Media dhe publiku nuk duhet të etiketojnë sinjalizuesit si “informatorë”, “spiunë”, apo me terma të tjerë me kuptime negative dhe diskriminuese.
9. Media të marrë më tepër informacion lidhur me zbatimin e ligjit, si dhe t’i japë publikut informacion në shërbim të tij, çka do të kontribuojë për të inkurajuar pozitivisht sinjalizuesit potencialë.

Në vlerësimin paraprak të jashtëm të kryer nga eksperti i pavarur i mbështetur financiarisht nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, mbi zbatimin e legjislacionit për sinjalizimin në sektorin publik dhe privat, si dhe dhënien e rekomandimeve për nevojën e ndërhyrjes në dispozitat e Ligjit nr. 60/2016, si rrjedhojë e miratimit të Direktivës së Bashkimit Evropian 2019/1937 “Mbi mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të së Drejtës së Bashkimit”, që ka hyrë në fuqi më 16 dhjetor 2019, gjetjet kryesore janë:

1. **Gjatë diskutimeve të hershme të draft ligjit dhe aprovimit të tij, ka pasur pritshmëri të ndryshme mbi çfarë risish do të sillte ky ligj, të tilla si rritja e raportimeve dhe zbulimi i menjëhershëm i çështjeve për korrupsion<sup>2</sup>. Siç është theksuar dhe në raporte të shumta, këto pritshmëri u transmetuan në mënyrë të gabuar nga disa media, që nuk e njihnin mirë konceptin e sinjalizuesit<sup>3</sup>. Këto të fundit në vend që të promovonin ligjin dhe funksionin e tij, duke përdorur konotacione negative në raportimin e ligjit si një rikthim në kohën e spiunëve<sup>4</sup> e stigmatizuan ligjin dhe praktikën e Sinjalizimit<sup>5</sup>, që tregoi për një keqkuptim të konceptit të Sinjalizimit. Legjislacioni i Sinjalizuesve në vetvete nuk do të sjellë një rritje të menjëhershme të zbulimit të rasteve të korrupsionit, pa marrë parasysh një kontekst më të gjerë. Në rastin e Shqipërisë, perceptimi i lartë i publikut mbi korrupsionin, besimi i ulët qytetar veçanërisht në**

<sup>2</sup> Shënim nga ILDKPKI: “Në përputhje me Raportin Përfundimtar të dorëzuar pranë ILDKPKI me datë 7 maj 2020”.

<sup>3</sup> Referencë nga Eksperti i Pavarur: “Palë të ndryshme interesi që kanë kontribuar vazhdimisht me vlerësime, analiza dhe raporte monitoruese mbi zbatimin e ligjit në Shqipëri, të tilla si Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit kanë identifikuar që media ka raportuar gabimisht miratimin e ligjit për shkak të mungesës së informacionit dhe njohurive mbi ligjin. KSHH, “Raporti Monitorues i Sinjalizuesve të korrupsionit dhe sfidat e legjislacionit të ri”, nëntor 2019, F. 26, Disponueshëm: [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi\\_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri\\_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf)”

<sup>4</sup> Referencë nga Eksperti i Pavarur: <http://fax.al/read/news/3920452/11812537/miratohet-ligji-i-spiuneve>, <https://exit.al/hyn-ne-fuqi-ligji-i-spiuneve-ne-kompanite-private-2/>

<sup>5</sup> Referencë nga Eksperti i Pavarur: Idem fotone no 50.

institucione gjyqësore dhe rënia e besimit social në përgjithësi – siç është theksuar nga indekse të shumta<sup>6</sup>, mund të kufizojë raportimin e sinjalizuesve.

2. Në njëfarë mase edhe vetë nenet e ligjit kanë kontribuar në perceptimin e gabuar të qëllimit të tij. Disa nga nenet e ligjit janë shkruar me një gjuhë të ngurtë (si psh. neni 2, nenet e kapitullin 4- Procedurat për hetimin administrativ), duke i dhënë ligjit natyrën e një ligji penal dhe jo të një ligji me një natyrë parandaluese dhe ndërgjegjësuere. Kështu, në paragrafin c) të nenit 2 parashikohet se qëllimi i ligjit është *nxitja* e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit, në vend që të ishte përzgjedhur një term më gjithëpërfshirës siç është *inkurajimi*, që është term i parashikuar nga Direktiva e BE.
3. Ndërgjegjësimi i ulët, për detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 60/2016 dhe aktet nënligjore, i anëtarëve të Njësive Përgjegjëse, si në sektorin publik dhe atë privat, pavarësisht seancave trajnuese dhe informuese të organizuara me donatorë të ndryshëm. Gjithashtu, niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve në shumicën e shoqërive tregtare që ushtrojnë aktivitet në sektorët e ndërtimit, fasonerive, të prodhimit ose shpërndarjes është ende në fazat e hershme.
4. Në sektorin privat, shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në fushën e sektorit bankar, telekomunikacionit, shoqëritë e sigurimit, si dhe shoqëritë që kanë një profil ndërkombëtar, kanë kapacitetin e duhur dhe profesional për zbatimin e ligjit, krahasuar me shoqëritë tregtare që veprojnë në fushën e ndërtimit, fasonerive, të prodhimit apo shpërndarjes.
5. Ekzistenca, ende, e një lloji skepticizmi të përgjithshëm mbi efektivitetin e ligjit në kontekstin shqiptar, shpesh i pa motivuar, ndërsa në disa raste motivohet nga niveli i ulët i besimit që njerëzit dhe organizatat private kanë te institucionet e administratës publike.
6. Mungesa e rishikimit të përskrimeve të punës për anëtarët e Njësive Përgjegjëse në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 23.9.2016, si dhe mungesa e rishikimit të kontratave të punës në funksion të rivlerësimit të kompesimit financiar.
7. Ligji nuk përkrah qartësisht, në radhë të parë sinjalizimet anonime. Parashikohet mundësia e një sinjalizimi anonim në kuadër të konfidencialitetit vetëm pasi të plotësohen kushtet e nenit 7 të ligjit. Kjo dispozitë lë vend për interpretime të ndryshme, sidomos nëse lidhet me nenin 15 “*Konfidencialiteti*”. Është e nevojshme të merret në konsideratë forcimi i parimit të konfidencialitetit, shkelja e të cilit, kryesisht në institucionet publike, është një nga çështjet kryesore që i pengon personat që duan të sinjalizojnë për të raportuar. Neni 23 duhet të parashikojë gjopa më të ashpra për shkeljen e konfidencialitetit.
8. Ligji nuk parashikon mbrojtje të mëtejshme të sinjalizuesve në rastet kur një sinjalizues vendos që informacionin ta bëjë publik në media dhe shoqëri. Sipas nenit 8 “*Sinjalizimi në publik*” parashikon se “*Në rast se sinjalizuesi njofton publikisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, gëzon të drejtën e mbrojtjes, sipas këtij ligji, deri në çastin kur sinjalizimi bëhet publik*”.
9. Raportet vjetore nga organizatat, si në sektorin publik dhe atë privat, nuk dorëzohen në zbatim të nenit 22/1 të ligjit. Në bazë të nenit 22/1 parashikohet se raportet vjetore mbi çështjet e regjistruara të sinjalizimit duhet të dërgohen me shkrim pranë ILDKPKI, brenda 15 janarit të vitit pasardhës. Disa nga organizatat, gjatë seancave të trajnimit, argumentuan se në mënyrën sesi është shkruar neni 22/1, ata duhet të paraqesin raportin vjetor vetëm

<sup>6</sup> Referencë nga Eksperti i Pavarur: “Idem footnote no. 11 – 14”.

nëse kanë të regjistruar raste të sinjalizimit. Nuk është e qartë nëse parashikimet ligjore dhe pritshmëritë e ILDKPKI janë që raporti vjetor duhet të paraqitet nga subjektet edhe kur ata nuk kanë regjistruar ndonjë rast. Neni 22/1, në formën si është shkruar ka krijuar një zonë gri për interpretime të ndryshme. Gjithashtu ligji, në bazë të nenit 23, nuk parashikon që subjekteve t’ju vendosen gjopa për mos paraqitjen e raportit vjetor tek ILDKPKI.

Gjithashtu, në këtë vlerësim janë paraqitur si shkaqe kryesore për mungesën e rasteve të sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin privat:

1. Hezitimi nga autoritetet vendimmarrëse të organizatave, për të inkurajuar sinjalizimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit, që mund të çojnë në zbulimin e informacionit dhe detajeve në media dhe publik. Kjo do të dëmtonte imazhin e organizatave dhe mund të çonte në dëme në reputacion.
2. Shoqëritë tregtare kanë tendencë të zgjidhin sinjalizimet e rasteve të dyshuara të korrupsionit, në kornizën e denoncimit të brendshëm të “*Speak Up*” (“Flisni” ose “Ngrini zërin”) ose Kodit të Etikës. Këto procedura parashikojnë hetimin e rasteve në dritën e shkeljeve etike të menaxhuara nga strukturat e burimeve njerëzore, duke shmangur kështu regjistrimin e sinjalizimeve, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 60/2016.

Në rekomandimet e dhëna në vlerësimin paraprak të jashtëm të kryer nga eksperti i pavarur i mbështetur financiarisht nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, lidhur me përmirësimin e zbatimit të kuadrit ligjor për sinjalizimin, si dhe ndikimi i Direktivës së Bashkimit Evropian 2019/1937, kryesisht evidentohet nevoja në:

1. Zhvillimin e seminareve dhe trajnimeve periodike me të gjitha Njësitë Përgjegjëse, për sinjalizimin në sektorin publik dhe privat, duke pasur parasysh nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të subjekteve private dhe publike për detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 60/2016 dhe aktet nënligjore.
2. Sektori privat dhe ai publik duhet t’u caktojë Njësitë Përgjegjëse për sinjalizimin, kapacitetet e duhura dhe të sigurojë trajnime periodike për punonjësit e tyre. Gjithashtu, duhet të përfshihen në mënyrë pro-aktive në veprime kolektive që promovojnë sinjalizimin.
3. Institucionet publike duhet të angazhohen në organizimin e sesioneve trajnuese të dedikuara për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, me nëpunësit e tyre dhe nëpunësit e institucioneve të varësisë, për t’i njohur ata me kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe procedurat për mbrojtjen nga hakmarrja.
4. Organizatat në sektorin privat, përfshirë bizneset dhe Dhomat/Shoqatat e Biznesit duhet të angazhohen në mënyrë aktive në përgatitjen e: Moduleve të Trajnimit On-Line, si metoda alternative për ndërgjegjësimin; Miratimin e Rregullores së Brendshme për procedurat e sinjalizimit për subjektet private që nuk kanë përgatitur një model, në përputhje me modelin e hartuar nga ILDKPKI.
5. Rritjen e përpjekjeve për promovimin e sinjalizimit përmes një fushate të targetuar për më shumë ndërgjegjësim në shoqëri, përmes bashkëpunimit të ngushtë me median. Qëllimi i një fushate të tillë duhet të jetë ndërtimi i kulturës së integritetit, si në entitetet private, ashtu edhe në ato publike, duke synuar ndryshimin e mentalitetit.
6. Promovimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira për çështjet e sinjalizimit të regjistruara dhe të hetuara nga Njësitë e Brendshme të Sinjalizimit dhe ILDKPKI, në

kuadër të aktiviteteve periodike ndërgjegjëse, Raportit Vjetor të ILDKPKI në Kuvend, shkrimeve dhe seancave informuese në media.

7. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike (DAP), të konsiderohet përfshirja e kompetencave dhe detyrave të anëtarëve të Njësive Përgjegjëse për sinjalizimin në përshkrimet e punës brenda institucionit.
8. Miratimi i Direktivës së re të BE duhet të shihet si një mundësi për të pasur në muajt e ardhshëm një shtysë në Shqipëri, për një proces të hapur diskutimi dhe konsultimi midis aktorëve të përfshirë, si ILDKPKI, Kuvendi i Shqipërisë, DAP, Shoqëria Civile, OJQ, donatorët, media, ndërmarrjet dhe shoqatat e sektorit privat, në lidhje me zbatimin e ligjit, përparësitë, mangësitë dhe veprimet e reja që duhet të ndërmerren për përmirësimin e tij.

Është me shumë rëndësi që një debat i tillë t'i paraprijë çdo nisme për ndryshime të shpejta në ligjin aktual.

Direktiva e BE ndikon drejtpërdrejt në parashikimet e mëposhtme të ligjit: fushëveprimin material (fusha e aplikimit); fushëveprimin personal (kush do të konsiderohet si sinjalizues), mënyrën e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe kushtet përkatëse; mbrojtjen e sinjalizuesve anonimë; mënyrën e krijimit dhe menaxhimit të kanaleve të raportimit; pragun e punonjësve në organizatat private, si parakusht për ngritjen e Njësive Përgjegjëse. Kështu, nëse merret në konsideratë vetëm transpozimi në ligjin kombëtar, i pragut minimal të punonjësve për organizatat private, si parakusht për ngritjen e Njësive Përgjegjëse (ref. neni 8 i Direktivës përcakton min 50 punonjës), ndikimi i tij mund të jetë i madh për sa i përket kapaciteteve, procedurave, burimeve njerëzore dhe buxhetit financiar për ILDKPKI, për të monitoruar dhe menaxhuar zbatimin e ligjit. Sipas të dhënave zyrtare të mbledhura nga INSTAT, numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve në Shqipëri, që kanë të paktën 50 të punësuar, do të ketë një impakt në rritjen me të paktën 3 herë të numrit të njësive përgjegjëse të ngritura deri më tani.

9. Duke marrë parasysh që dispozitat e Direktivës së BE janë gjithashtu të reja, madje edhe për shumicën e vendeve të BE, të cilat ende nuk kanë një ligj të posaçëm për mbrojtjen e sinjalizuesve, nuk rekomandohet transpozimi i menjëhershëm i dispozitave të direktivës në ligjin tonë. Direktiva e aprovuar e BE do të mundësojë hartimin dhe nxjerrjen e ligjeve të reja mbi mbrojtjen e sinjalizuesve, që do të krijojnë një praktikë zgjidhjesh konkrete mbi parimet e përcaktuara nga kjo direktivë. Këto ligje mund të jenë praktikë më të mira që mund të merren si model për çështjen e Shqipërisë. Ligji nr. 60/2016 ka akoma një nivel të mirë dhe të arsyeshëm të përputhshmërisë me Direktivën e miratuar.
10. Mbi bazën dhe argumentet e mësipërme, si dhe në përputhje me Metodologjinë për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator, rekomandohen opsionet e mëposhtme:
  - Strukturat legjislative dhe institucionale duhet të vlerësohen me kujdes, të mbështeten me kapacitete, burime buxhetore, me fokus të veçantë dhe të miratohen vetëm pas një procesi më të gjerë konsultimi dhe në përputhje me afatet kohore të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për ndryshimet e Ligjit nr. 60/2016, brenda vitit 2022.
  - Çdo ndryshim i pjesshëm i ligjit, do të ishte kundër-produktiv, siç tregohet në raste të tjera dhe do të rrezikonte zbatimin e mëtejshëm të tij.
  - Përveç përafrimit dhe transpozimit me direktivën, rekomandohet që ndryshimet e

mundshme të marrin në konsideratë përvojën e fituar dhe sugjerimet e bëra nga përdoruesit e ligjit dhe aktorët e brendshëm.

Në vlerësim të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e paraqitur nga KSHH dhe në vlerësimin paraprak të jashtëm të kryer nga eksperti i pavarur i mbështetur financiarisht nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, si dhe vështirësitë e hasura nga Inspektorati i Lartë, gjatë përmbushjes së detyrave funksionale në kuadër të Ligjit nr. 60/2016, konstatohet nevoja për:

- 1- Vijimin e iniciativave trajnuese, informuese dhe ndërgjegjësuere për njohjen në një shkallë më të gjerë të parashikimeve ligjore të sinjalizimit dhe mekanizmave mbrojtës për nëpunësit dhe Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik dhe privat.
- 2- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Njërive Përgjegjëse, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë, pavarësisë dhe efijencës së tyre, duke përfshirë detyrat që rrjedhin nga legjislacioni për sinjalizimin në përkrahjet dhe kontratat e punës së nëpunësve që janë pjesë e Njërive Përgjegjëse. Vlerësimi i mundësisë për t'ju garantuar një trajtim financiar të përshtatshëm.
- 3- Emërimin pranë Njërive Përgjegjëse të nëpunësve apo punonjësve të cilët kanë treguar integritet dhe profesionalizëm në përmbushjen e detyrave funksionale.
- 4- Forcimin e mekanizmave për garantimin e konfidencialitetit nga Njësitë Përgjegjëse për të gjithë nëpunësit që sinjalizojnë raste të dyshuara korrupsioni pranë tyre, si dhe vlerësimin e ashpërsimit të sanksioneve për rastet e shkeljeve të parimit të konfidencialitetit.
- 5- Rishikimin e mekanizmave shtrëngues për plotësimin e kërkesave të nenit 22 të Ligjit nr. 60/2016, pasi nga administrimi i raporteve vjetore, rezulton se nga sektori publik, kryesisht Njësitë Përgjegjëse në pushtetin vendor, si dhe nga sektori privat, raportet nuk dorëzohen brenda afatit ligjor të parashikuar. Në disa raste, këto raporte nuk janë dorëzuar edhe përtej afatit ligjor.
- 6- Me miratimin e Direktivës së Bashkimit Evropian 2019/1937 dhe në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE është e nevojshme kryerja e analizës së plotë ligjore për të identifikuar dispozitat të cilat duhet të ndryshohen dhe të amendohen në kuadër të kësaj Direktive. Në vlerësimin paraprak të jashtëm të kryer nga eksperti i pavarur i mbështetur financiarisht nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, ndonëse konstatohet një nivel i kënaqshëm i përputhshmërisë së ligjit për sinjalizimin me Direktivën 2019/1937, evidentohen nenet 1, 2, 3, 7, 8, 10, 18, 19 dhe 20, të Ligjit nr. 60/2016, të cilët preken nga kjo Direktivë.

Megjithatë, çdo ndërhyrje në kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve duhet të bëhet pas zhvillimit të diskutimeve dhe konsultimeve midis të gjithë aktorëve të përfshirë, si ILDKPKI, Kuvendi i Shqipërisë, DAP, Shoqëria Civile, OJQ, donatorët, media, ndërmarrjet dhe shoqatat e sektorit privat, mbi zbatimin e ligjit, përparësitë, mangësitë dhe veprimet e reja që duhet të ndërmerren për përmirësimin e tij, në kuadër të ndikimit të Direktivës së BE.

Ndikimi i drejtëpërdrejtë i Direktivës, duke filluar që nga fusha e gjerë e aplikimit dhe minimumi i pragut të punonjësve, që duhet të ketë një organizatë për të ngritur Njësi Përgjegjëse, është i konsiderueshëm dhe duhet të paraprihet nga një vlerësim i kapaciteteve,



procedurave, si dhe mekanizmave e kanaleve të raportimit.

Gjithashtu, vlerësohet me rëndësi ndjekja e zhvillimeve në vendet anëtarë të BE në hartimin dhe miratimin e ligjeve për sinjalizimin, të cilat mund të shërbejnë si modele dhe praktika të mira që mund të përshtaten për realitetin e Shqipërisë.

### **1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË**

Sistemi Elektronik i deklarimit të interesave privatë është një mekanizëm i rëndësishëm në forcimin e mjeteve investiguese/kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, me impakt të ndjeshëm jo vetëm në luftën kundër korrupsionit në të gjitha kategoritë e zyrtarëve, të cilët kryejnë funksione publike, por edhe në përmbushjen e pritshmërisë qytetare në rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në rradhët e zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.

Në këtë kuadër, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2019, ku është theksuar vijueshmëria në *“Angazhimin, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar përfundimin e të gjitha fazave të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksionim të Sistemit Elektronik të deklarimit të interesave privatë brenda vitit 2021 dhe garantimin e qëndrueshmërisë së mëtejshme të funksionimit të vetë sistemit”*, përgjatë vitit raportues, ka vazhduar procesi i koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të projekteve asistuese në drejtim të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, Inspektorati i Lartë, është asistuar financiarisht dhe teknikisht nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në lidhje me pjesën e programimit të sistemit (*software*), si dhe nga “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” i bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, lidhur me sigurimin e pajisjeve (*hardware*).

Në zbatim të ndryshimeve të Ligjit nr. 9049/2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, në vitin 2017, ku u prezantua koncepti i plotësimit dhe dorëzimit elektronik të deklaratave të pasurisë/interesave privatë, si dhe ndryshimeve ligjore në vitin 2018, është vijuar me përpjekjet drejt zbatimit të një prej prioriteteve më të rëndësishme të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale në Luftën Kundër Korrupsionit: *“përmirësimi i sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e deklaratave të interesave privatë, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së Inspektoratit të Lartë, duke e çuar drejt publikimit automatik të deklarimeve online”*.

Për këtë qëllim, gjatë periudhës raportuese, në bashkëpunim me kompaninë zbatuese të projektit, përgjegjëse për dizajnimin dhe instalimin e *software* të sistemit, gjatë muajit shkurt 2019 është përfunduar procesi i instalimit të bazës së të dhënave dhe aplikacionit. Ky proces është kryer në vijim të përfundimit të virtualizimit dhe përfundimit të sistemit operativ të zbatuar nga kompania tjetër përgjegjëse për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike *hardware*. Të dyja këto veprime operationale, janë shoqëruar me asistencë teknike dhe trajnime për përdoruesit kryesorë të sistemit, si dhe stafin teknik dhe përdorues të tjerë të sistemit, pjesë e stafit të ILDKPKI. Gjithashtu, janë kryer testimet dhe riestimet e nevojshme në kuadër të testeve të integruara të sistemit, të cilat kanë përfunduar në qershor 2019.

Kompania zbatuese përgjegjëse për pajisjet *hardware* ka organizuar gjatë muajit shkurt 2019, trajnimin e posaçëm për stafin teknik të ILDKPKI me qëllim njohjen me karakteristikat, veçoritë dhe përdorimin e infrastrukturës së serverave dhe rrjetit, ndërtuar për hostimin e Sistemit Elektronik. Ndërkohë që kompania zbatuese e *software*, gjatë periudhës së raportimit ka përgatitur manualët dhe materialet e trajnimit të dedikuara sipas moduleve dhe roleve që parashikon sistemi. Bazuar në këto materiale trajnimi, janë organizuar rreth 8 raunde trajnimesh me pjesëmarrjen e të gjithë stafit, përdorues të sistemit.

Një tjetër aktivitet i ndërmarrë nga kompania zbatuese e *software* në bashkëpunim me ILDKPKI dhe mbështjetjen e USAID, ka qenë organizimi i trajnimeve, gjatë periudhës prill - maj 2019, për Autoritetet Përgjegjëse, mbi funksionimin e Sistemit Elektronik, ku morën pjesë **366 përfaqësues**. Skenarët përfundimtarë të testeve nga përdoruesit dhe pranimit të funksionaliteteve të sistemit u kryen gjatë dy javëve të para të muajit qershor 2019.

Gjithashtu gjatë vitit 2019, u morën masat e nevojshme për planifikimin e punës për përgatitjen dhe përditësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm. Për këtë, në muajin shtator 2019 përfundoi procesi i regjistrimit të sistemit si bazë të dhënash shtetërore, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe u dakordësua përmbajtja e projekt-aktit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, i cili do t'i përcillet Ministrisë së Drejtësisë për marrjen e iniciativës ligjore dhe miratimin e mëtejshëm nga Këshilli i Ministrave.

Në vijim të procesit të garantimit të qëndrueshmërisë së sistemit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve financiare, për të siguruar mirëmbajtjen e sistemit, si një kërkesë e domosdoshme në zbatim të VKM nr. 710/2013, u morën të gjitha masat institucionale në parashikimin dhe alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore nga buxheti i shtetit.

Inspektorati i Lartë, në vitin në vazhdim mbetet tërësisht i angazhuar për përfundimin e të gjitha proceseve të nevojshme ligjore dhe teknike, për krijimin dhe funksionalizimin e Sistemit Elektronik të deklarimit të interesave privatë, me qëllim përmbushjen e afatit të përcaktuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për vitin 2021.

## 2. TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË

### 2.1. ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE


Gjatë vitit 2019, Inspektorati i Lartë ka vijuar punën me procesin e pranimit, regjistrimit dhe administrimit të deklaratave të interesave privatë, të subjekteve që mbartin detyrim për deklaram. Nga të dhënat e regjistruara dhe të administruara nga Sektori i Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë, rezultojnë se numri i përgjithshëm i subjekteve (subjekte në funksion, ish-subjekte deklarues, kandidatë) deri më 31.12.2019 është **15.540 subjekte deklarues**, nga të cilët:

- **17.3% ose 2.689 subjekte rezultojnë të jenë në funksion;**
- **81.8% ose 12.718 subjekte rezultojnë të jenë ish-subjekte deklarues;**
- **0.9% ose 133 subjekte rezultojnë të jenë kandidatë.**

Numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2019, është **3.868 deklaratat të interesave privatë**, nga të cilat, të ndara sipas llojeve të tyre, rezultojnë këto të dhëna statistikore:

- Deklarata Periodike/Vjetore – **2.680 deklaratat;**
- Deklarata Para Fillimit të Detyrës – **512 deklaratat;**
- Deklarata Pas Largimit nga Funksioni – **548 deklaratat;**
- Deklarata Kandidati – **128 deklaratat.**

Sikurse mund të vihet re edhe nga paraqitja grafike, 69.3 % e totalit të deklaratave të interesave privatë, të administruara nga ILDKPKI gjatë vitit 2019, përbëhet nga deklaratat Periodike/Vjetore, 13.2 % nga deklaratat Para Fillimit të Detyrës, 14.2% e tyre përbëhet nga deklaratat Pas Largimit nga Funksioni, si dhe 3.3 % e përbëjnë deklaratat e kandidatëve.



## 2.2. SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK.

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues, ka administruar **3.868 deklaratat të interesave privatë**. Të gjitha deklaratat, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 24 i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, që parashikon kalimin në fazën e skanimit, kontrollit të përpunimit paraparak, kryesisht lidhur me juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës, i janë nënshtruar këtij procesi, të përfunduar brenda vitit 2019. Për më tepër, njëkohësisht me procesin e skanimit dhe kontrollit paraparak, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 25 i Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, është kryer dhe procesi i kontrollit aritmetik dhe logjik, mbi saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara.

Në përfundim të procesit të kontrollit aritmetik e logjik, brenda datës 31.12.2019, janë kontrolluar të gjitha deklaratat e interesave privatë të administruara në vitin raportues, në total 3.868 deklaratat të interesave privatë.

## 2.3.KONTROLLI I PLOTË

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit 2019, në zbatim të nenit 25/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, si dhe në përmbushje të objektit kryesor të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimin administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, ka miratuar dhe ka kaluar në kontroll të plotë në **total 1,417 subjekte deklarues**, si për shkak funksioni, ashtu edhe bazuar në informacione të ardhura nga denoncimet në numrin pa pagesë **0800 9999**, postën zyrtare dhe elektronike, median e shkruar, audio-vizive, etj.

## 2.4. REZULTATET E KONTROLLIT

Inspektorati i Lartë në përmbushje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2019, e cila kërkonte që: “*Të vijojë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve investiguese me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të fshehjes apo mosdeklarimit të pasurive, të konfliktit të interesit, si dhe hetimit të rasteve të sinjalizimit*” ka përmbushur kompetencat e tij ndëshkuese, përmes aplikimit të masave administrative, “gjobë”, propozimeve për masa disiplinore deri në largim nga detyra, drejtuar institucioneve publike, si dhe kallëzimeve/referimeve penale të depozituara pranë organit të akuzës, strukturave të hetimit tatimor, Policisë së Shtetit apo Drejtorisë së Prandalimit të Pastrimit të Parave, ndaj zyrtarëve-subjekte deklarues, të cilët janë gjetur në shkelje të ligjit.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë, në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave...*”, i ndryshuar dhe nenit 40, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, ka aplikuar masën administrative “gjobë”, për rastet e refuzimeve për deklarim, si dhe për rastet e mosdeklarimeve dhe/apo për çështje të konfliktit të interesave. Të ndëshkuar me masa administrative, “gjobë”,

për periudhën deri më 31.12.2019 janë në **total 54 zyrtarë**. Për periudhën 2014 – 2019 janë sanksionuar me masë administrative “gjobë” në total rreth **1.726 zyrtarë**.

Për t’u theksuar është fakti se të gjitha masat administrative të vendosura nga Inspektorati i Lartë janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative, me përjashtim të një numri të pakonsiderueshëm, për të cilat gjykata ka vendosur shfuqizimin ose ndryshimin e tyre.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës 2014 – 2019, ka referuar pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe Policisë së Shtetit, **430 subjekte**, në të cilët janë përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë drejtues, si Deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetarë Bashkie, Drejtorë Drejtorie etj. Për periudhën raportuese janë paraqitur në **total 115 raste kallëzime penale dhe referime të tjera**.

### 3. ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë vitit raportues i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rolit ndërgjegjësues dhe parandalues, në funksion të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 60/20162016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Ky rol është ushtruar duke përdorur të gjitha mjetet ligjore dhe institucionale në dispozicion të institucionit, duke arritur në organizimin e një sërë sesionesh trajnuese e informuese për Autoritetet Përgjegjëse, Njësitë Përgjegjëse, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe zyrtarë të lartë të administratës publike.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Kuvendin, përgjatë periudhës raportuese, është organizuar një sesion trajnimi me natyrë teknike dhe procedurale, për deputetët e rinj të Kuvendit të Shqipërisë, në lidhje me zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit. Sesioni trajnues u fokusua në trajtimin e çështjeve lidhur me përcaktimin e qartë të konceptit të “konfliktit të interesave”, bazën ligjore të konfliktit të interesave, llojet e konfliktit të interesave, kufizimet e interesave vetjake, mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjeve, zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve dhe Udhëzuesit për zbatimin e këtij Kodi.

Gjatë vitit raportues, është vijuar me rritjen e kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse pranë autoriteteve publike dhe private, të ngarkuara për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, duke ju dhënë në mënyrë të vazhdueshme asistencë për çështje të parashtruara, lidhur me njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor, si dhe ofrimin e sesioneve trajnuese.

Në këtë kuadër, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, në përputhje me parashikimet lidhur me organizimin e sesioneve trajnuese për Njësitë Përgjegjëse, pranë institucioneve publike, si dhe organizimin e një fushate ndërgjegjësuere, bazuar mbi kurrikulën trajnuese të

rishikuar, si dhe kalendarit të dakordësuar me ASPA, në tremujorin e parë të vitit 2019, u zhvilluan **14 sesione trajnuese** për Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik, si në nivel qendror dhe atë vendor, me pjesëmarrjen e **217 anëtarëve nga Njësitë Përgjegjëse**.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë në bashkëpunim të ngushtë me OSBE përgjatë vitit raportues, mori të gjitha masat për organizimin me sukses të **8 seminareve trajnuese** për Njësitë Përgjegjëse në sektorin privat, gjatë të cilave u arrit të trajnoheshin **95 anëtarë** nga Njësitë Përgjegjëse pranë këtij sektori.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve ligjore, në mënyrë periodike, por dhe rast pas rasti, në bazë të kërkesave, është ofruar asistencë teknike dhe ligjore për Autoritetet Përgjegjëse, si strukturat kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit, ku ushtrojnë funksionet e tyre.

Duke qenë se Autoritetet Përgjegjëse janë ato që evidentojnë, administrojnë dhe trajtojnë konfliktin e interesave rast për rast, çdo herë, kur institucionet publike i janë drejtuar zyrtarisht Inspektoratit të Lartë, duke i kërkuar asistencë ligjore për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, Inspektorati i Lartë është përgjegjës duke organizuar takime të veçanta sqaruese me zyrtarë të niveleve të ndryshme brenda të njëjtit institucion, mbi problematikat institucionale apo individuale të ndeshura.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në përmbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, ka administruar brenda afatit ligjor, raportet e dërguara nga çdo Autoritet Përgjegjës, lidhur me veprimtarinë e kryer prej tyre në zbatim të ligjit, përfshirë edhe rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarinimin periodik të interesave privatë.

## **4. BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR**

### **4.1. BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I BRENDSHËM**

Inspektorati i Lartë, duke e vlerësuar bashkëpunimin ndër-institucional me organet ligjzbatuese, si një element të domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontroleve dhe hetimeve administrative, ka vijuar përgjatë vitit raportues zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet kryesore në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe krimit të organizuar, konkretisht me KLSH, Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve/Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Përgjatë vitit raportues, janë konsoliduar marrëdhëniet e bashkëpunimit në kuadër të marrjes së informacioneve nga institucionet publike dhe private, në kuadër të verifikimit të të dhënave të pasqyruara nga subjektet e përfshira në procesin e rivlerësimit kalimtar (vettingut) në

sistemin e drejtësisë, vlerësimin në rradhët e Policisë së Shtetit e Gardën e Republikës së Shqipërisë, si dhe për kandidatët në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Ky bashkëpunim përfshiu institucionet publike dhe private, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ASHK, QKB, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSHEE, etj.), dhe u zgjerua me institucione të tjera në varësi të ecurisë së procesit të kontrollit dhe nevojës për të marrë informacion shtesë.

Inspektorati i Lartë, përtej përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, ka vazhduar të japë në mënyrë periodike/mujore arritjet dhe sfidat institucionale të tij, me qëllim përbushjen e rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE) për Prioritetin 2 “Të sistemit të drejtësisë” dhe Prioritetin 3 “Të luftës kundër korrupsionit”, duke ju përgjigjur në kohë institucioneve të tjera shtetërore të përfshira në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, si Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit/Ministrinë e Drejtësisë.

#### **4.2.BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË**

ILDKPKI, përgjatë vitit raportues, ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, me Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID, Këshillin e Evropës, zyrën e OSBE-së në Tiranë, si dhe ka pasur në fokus të punës, forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve institucionale dhe shtimin e kontakteve me zyrat homologe apo agjencitë antikorrupsion në rajon dhe më gjerë.

Në këtë kuadër, me qëllim avancimin e përpjekjeve për të finalizuar ngritjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave, u organizuan në bashkëpunim me USAID sesione trajnuese për nëpunësit e ILDKPKI, si dhe për Autoritetet Përgjegjëse mbi funksionimin e Sistemit Elektronik. Këto trajnime u organizuan gjatë periudhës prill - maj 2019, ku u trajnuan 366 persona, përfaqësues të Autoriteteve Përgjegjëse, si në nivel qendror edhe në nivel vendor.

Në kuadër të koordinimit të procesit të bashkëpunimit midis projekteve të Këshillit të Evropës/BE dhe USAID, për ofrimin e asistencës teknike dhe financiare në ngritjen e Sistemit Elektronik të deklarimit të interesave privatë, gjatë muajit maj 2019, u organizuan, me mbështetjen e KiE dhe USAID, një sërë tryezash të rumbullakëta informuese me temë *“Rrugëtimi drejt ngritjes dhe funksionimit të sistemit të ri elektronik të deklarimit dhe publikimit të interesave privatë, të personave të zgjedhur dhe disa nëpunësve publikë”* me përfaqësues nga institucionet shtetërore bashkëpunuese të ILDKPKI, shoqërinë civile dhe median, si dhe me komunitetin e donatorëve. Këto tryeza kishin si synim të paraqisnin, konsultonin dhe diskutonin Sistemin Elektronik të deklarimit dhe publikimit të interesave privatë nga një pikëpamje teknike dhe funksionale.

Inspektorati i Lartë ka qenë i angazhuar me pjesëmarrjen në takime, tryeza të rumbullakëta, konferenca dhe seminare për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit. Konkretisht,

përfaqësues të ILDKPKI morën pjesë në Konferencën Rajonale të organizuar në Maqedoni, në datë 9 tetor 2019, në kuadër të lançimit të fazës së dytë të Programit të financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës “Horizontal Facility II” për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. ILDKPKI është parashikuar si një prej institucioneve përfituese të këtij programi, në projektin “Veprimi kundër Krimet Ekonomik në Shqipëri”.

Gjithashtu, u përfaqësua në Konferencën Ndërkombëtare në luftën dhe parandalimin e korrupsionit me temë “Adresimi i sfidave aktuale në fushën e parandalimit të korrupsionit nëpërmjet metodave inovative”, të organizuar në Beograd më 12 dhjetor 2019, nga Agjencia Kundër Korrupsionit e Serbisë, në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë kundër Korrupsionit “Kapacitetet, Kompetencat dhe Koordinimi i Agjencive përgjegjëse për Luftën kundër Korrupsionit- Lufta kundër Korrupsionit për shoqëri më të mira në Evropën Jug-Lindore”, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë në Beograd, në datat 4 - 5 nëntor 2019, si dhe aktivitetin e organizuar nga SELDI më datat 12 - 14 qershor 2019, me fokus në temën “Monitorimi, Advokimi dhe Ndikimi i Korrupsionit dhe Kapjes së Shtetit në një Botë të kërcënimeve të ndërthurura” të mbajtur në Sarajevë.

ILDKPKI, mori pjesë edhe në seminarin prezantues të Direktivës së Re të Bashkimit Evropian mbi Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, për të gjitha vendet e rajonit të cilat aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian dhe po kalojnë nëpër procesin e zgjerimit, siç janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, i cili u organiza nga Instrumenti i Ndhmës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX) i Komisionit Evropian, në Bruksel, në datë 7 tetor 2019.

Gjithashtu, në vijim të zbatimit të komponentit lidhur me ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, gjatë vitit raportues, në përputhje me parashikimet lidhur me organizimin e sesioneve trajnuese për Njësitë Përgjegjëse pranë institucioneve publike, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, bazuar mbi kurrikulën trajnuese të rishikuar si dhe kalendarit të dakordësuar me ASPA-n, në tremujorin e parë të vitit 2019, u zhvilluan **14 sesione trajnuese** për Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik, si në nivel qendror dhe atë vendor, me pjesëmarrjen e **217 anëtarëve nga Njësitë Përgjegjëse**.

Në drejtim të rritjes së kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse pranë sektorit privat, gjatë vitit raportues, bashkëpunimi me OSBE ka qenë i sukseshëm në realizimin e **8 seminareve** trajnuese për Njësitë Përgjegjëse në sektorin privat, gjatë të cilave u trajnuan **95 anëtarë** nga Njësitë Përgjegjëse pranë këtij sektori.

Për sa më sipër, mbështetja operationale e partnerëve ndërkombëtarë apo me ekspertë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, ka qenë e vlefshme dhe e mirëpritur nga Inspektorati i Lartë, ndaj i falenderojmë publikisht për ndihmesën e tyre.

## 5. TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

ILDKPKI përgjatë vitit raportues ka vijuar ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median, shoqërinë civile, si dhe forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative.



Në kuadër të mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë, përgjatë vitit 2019, Inspektorati i Lartë ka trajtuar të gjitha kërkesat e individëve apo mediave, lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit të përpunimit manual për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Në këtë kuadër, për t'u theksuar mbetet fakti se nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara, çka tregon për një punë korrekte dhe serioze të institucionit.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku ILDKPKI për vitin 2019 ka publikuar rreth **10,937 deklaratata**.

## 6. PERFORMANCA FINANCIARE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2019, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të Ligjit nr. 99/2018, "*Për Buxhetin e vitit 2019*", Udhëzimit nr. 1, datë 17.1.2019, "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019*", i ndryshuar, dhe shkresës nr. 9078/1 prot., datë 21.5.2019, "*Për miratimin e detajimit të fondit të veçantë për vitin 2019*" nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është akorduar fondi buxhetor prej 142,880,000 lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 102,500,000 lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15,700,000 lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 21,260,000 lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 3,000,000 lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 420,000 lekë (zëri 606)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Ligjit nr. 99/2018, "*Për Buxhetin e vitit 2019*", për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në shumën 133,473,218.34 lekë ose 93.42%, të fondit të planifikuar për vitin 2019.

ILDKPKI, referuar buxhetit të vitit 2019, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara, si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar*", i ndryshuar.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri i punonjësve u realizua deri në 70 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 48, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 101,430,020 lekë ose 99% e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 14,027,457 lekë ose 89.3%, e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

Për vitin 2019, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante në kategorinë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese, si dhe nivelin e lartë drejtues.

Për vitin 2019, në realizimin e shpenzimeve buxhetore, Inspektorati i Lartë është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit të plotë të infrastrukturës institucionale, të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave privatë dhe me zbatimin e politikave buxhetore, përmes përdorimit ekonomik dhe efektiv të burimeve financiare. Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2019, në realizimin e shpenzimeve operative, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- ✓ Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare, në funksion të një veprimtarie normale institucionale, të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar në masën 100% të fondit të planifikuar vjetor;
- ✓ Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional;
- ✓ Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ Rritjes së numrit të hetimeve administrative, të filluara kryesisht nga denoncimet e qytetarëve, shoqërisë civile, medias, biznesit etj;
- ✓ Forcimit të vazhdueshëm të bashkëpunimit të ILDKPKI, me organet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse, për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;
- ✓ Zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologji - informacion.

Gjatë këtij viti, shpenzimet buxhetore të domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara krahas prokurimit me tender, janë realizuar dhe me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike dhe janë lidhur kontrata në mbështetje të specifikimeve teknike, të sanksionuara në marrëveshjet

dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI për vitin 2019, kanë ardhur kryesisht nga arkëtimi i sanksioneve administrative me gjobë, të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe ekzekutimit të detyrueshëm nga Zyrat e Përmbartimit, për një vlerë totale prej **16.102.925 lekë**. Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.

ILDKPKI, për vitin e ardhshëm, mbetet i angazhuar në vazhdimin e ndjekjes së një politike menaxhuese efektive, të fondeve buxhetore të akorduara, forcimin e sistemeve të brendshme të kontrollit, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore, duke mundësuar zbatimin efektiv të objektivave të institucionit, në funksion të një vendimmarrjeje transparente në zbatim të kompetencave të dhëna nga kuadri ligjor në fuqi.

## 7. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Në vijim të punës dhe angazhimit të marrë, lidhur me rritjen e performancës institucionale, gjatë vitit të gjashtë të ushtrimit të mandatit si Inspektor i Përgjithshëm, më lejoni që në vija të përgjithshme të parashtrij arritjet, me theks të veçantë në:

- Marrjen e të gjitha masave institucionale me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingut), duke garantuar procesin e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të deklaratave të pasurisë për **794 subjekte të rivlerësimit**;
- Vazhdimin e verifikimit të të dhënave të pasqyruara në deklaratat e pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, në dokumentet justifikuese e shoqëruese lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë, nëpërmjet kërkimit dhe marrjes së të dhënave nga personat juridikë publikë dhe privatë **për më shumë se 3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).
- Përfundimin brenda afateve ligjore të proceseve të kontrollit të deklaratave të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, të përcaktuar në listat e dërguara nga organet e vettingut KPK dhe ONM, në afatet e caktuar prej tyre, konkretisht u përfundua dhe u dorëzua pranë këtyre organeve, dokumentacioni i plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, për pjesën e mbetur të gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe prokurorëve pranë prokurorive të apelit, si dhe për një pjesë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.
- Në total **për periudhën janar - dhjetor 2019**, përfundoi procesi i dorëzimit për **220 subjekte të procesit të rivlerësimit**. Ky numër, së bashku me subjektet e përfshirë për periudhën **janar - dhjetor 2018**, si dhe listën prioritare, të dërguar pranë këtyre

institucioneve përgjatë periudhës **nëntor - dhjetor 2017**, shkon në total në **715 subjekte të procesit të rivlerësimit**.

- Mbështetjen e proceseve për emërimin e kandidatëve në pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë duke përfunduar brenda afateve ligjore kontrollin e plotë **për 135 kandidatë** në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, si për Prokurorë të Përgjithshëm, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, magjistratë, dhe dërgimin e akteve të kontrollit, së bashku me dosjet përkatëse pranë KED, KLGJ dhe KLP.
- Zbatimin me rigorozitet të skemës së kontrollit të plotë, ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, **për 1.417 subjekte deklaruese**.
- Ndëshkimin e të gjithë shkelësve të kuadrit ligjor, duke aplikuar **54 masa administrative “gjobë”** dhe depozituar **115 referime penale dhe referime të tjera** pranë institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe strukturave të Policisë së Shtetit.
- Marrjen e të gjitha masave ligjore dhe institucionale, lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*. Në këtë kuadër, u zhvilluan sesione trajnuese për sektorin publik dhe privat, si dhe u bashkëpunua ngushtësisht me Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe OSBE, në zhvillimin e aktiviteteve trajnuese dhe vlerësuese mbi zbatueshmërinë e këtij ligji.
- Marrjen e të gjitha masave ligjore dhe institucionale, lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, në drejtim të rritjes së kapaciteteve të Autoriteteve Përgjegjëse. Kështu, gjatë vitit raportues, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit, ekspertët vendas dhe ASPA, u zhvilluan **14 sesione trajnuese** në nivel qendror dhe atë vendor me pjesëmarrjen e **217 anëtarëve nga Njësitë Përgjegjëse**.
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ku përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë me burimet e tij institucionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Kuvendit, gjatë muajit qershor 2019, zhvilloi një sesion trajnimi me natyrë teknike dhe procedurale për deputetët e rinj të Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave, gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit.
- Në zbatim të nenit 4/2 dhe nenit 34, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”*, i ndryshuar, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësisë dhe dorëzimit të deklaratave në mënyrë elektronike, Inspektorati i Lartë vijoi procesin e ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, duke siguruar zbatimin e detyrimeve kontraktuale lidhur me zhvillimin e programit të sistemit dhe instalimit/konfigurimit të pajisjeve elektronike të nevojshme për këtë sistem.
- Ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, ku të gjitha kërkesat e paraqitura për publikim të deklaratave të interesave privatë, janë trajtuar në

përputhje me afatet ligjore, gjë që ka rezultuar në **publikimin e rreth 10,937 deklaratave të interesave privatë, gjatë vitit 2019.**

## 8. PRIORITET PËR VITIN 2020

- Ruajtja dhe forcimi i pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë dhe objektivitetit të Inspektoratit të Lartë;
- Vendosmëria në luftën kundër korrupsionit, duke garantuar vijueshmërinë e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për përmbylljen me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting) në hartimin dhe dërgimin pranë institucioneve të rivlerësimit dhe ONM, të dokumentacionit të plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i Ligjit nr. 84/2016;
- Mbështetja e proceseve për verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe forcimi i bashkëpunimit me organet përkatëse të emërtesës.
- Ndjekja dhe zbatimi i skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin...*”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave...*”, i ndryshuar;
- Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe ndërgjegjësimi i mëtëjshëm i publikut të gjerë mbi këtë mekanizëm raportimi;
- Forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë;
- Vazhdimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimi i mëtëjshëm i urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informuese ligjore e publike, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë.

**ANEKSI NR. 1**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, për çështjet e përfshira në planin e veprimit, për të cilat është kërkuar raportim në një aneks të veçantë të Raportit Vjetor, Inspektorati i Lartë parashtron sa më poshtë vijon:

**A- Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të kuadrit ligjor, Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” ka në kompetencë të tij, sanksionimin me anë të masave administrative “gjobë” për shkelje të konstatuara të dispozitave ligjore, nga subjektet deklaruese apo Njësitë/Autoritetet Përgjegjëse.

Për të gjitha masat administrative “gjobë” Inspektorati i Lartë ka ndjekur rrugët ligjore për të garantuar vënien e tyre në ekzekutim vullnetar ose të detyrueshëm nga ana e subjekteve të sanksionuara.

**B- Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të funksioneve të institucionit.**

- **Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm**

Në strukturën e ILDKPKI nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2019, ILDKPKI nuk ka qenë e përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe në planin e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Megjithatë, përgjatë vitit 2019, në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku është përcaktuar përgjegjshmëria menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin në institucion, duke arritur objektivat e përcaktuara dhe shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë. Gjithashtu, në zbatim të ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, u vlerësua se ILDKPKI ka nxjerrë një sërë aktesh në zbatim rigoroz të tij, për menaxhimin e aktiveve.

#### - **Plani i veprimit të institucionit**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbështet planin e veprimit të institucionit në zbatim të skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë, përcaktuar nga neni 25/1, i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, duke kryer kontrollet e deklaratave të interesave privatë të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Gjithashtu, në kuadër të reformës në drejtësi, në zbatim të Ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe fillimin e zbatimit të Ligjit nr. 12/2018, datë 5.3.2018 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve institucionale do të vazhdojnë të jenë të angazhuar në verifikimin dhe hetimin e deklaratave të pasurive të subjekteve të përfshirë në procesin e vlerësimit kalimtar (vettingut), si në rradhët e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe në rradhët e Policisë së Shtetit.

Në objektivat institucionale të Inspektoratit të Lartë për vitin në vijim, mbetet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative dhe investiguese, si dhe forcimi i bashkëpunimit me Autoritetet Përgjegjëse dhe Njësitë Përgjegjëse në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave...*”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 60/20162016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

#### - **Pasqyrat financiare**

### **TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI**

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2019 I Rishikuar	Buxheti I realizuar Viti 2019	Realizimi në % Viti 2019
600	Fond Page	102.500,00	101.430,02	99,0%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shend	15.700,00	14.027,46	89,3%
602	Shpenzime operative	21.260,00	16.664,99	78,4%
606	Transferta per financime te tjera	420,00	289,35	68,9%
231	Investime	3.000,00	1.061,40	35,4%
<b>Shuma</b>		<b>142.880,00</b>	<b>133.473,22</b>	<b>93,42%</b>

#### - Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë vitit raportues, ka aplikuar **54 sanksione** administrative me “gjobë”, për mosdeklarim të interesave privatë, konfliktit të interesave, si dhe për shkelje të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Nga këto, janë ankimuar pranë organeve gjyqësore vetëm **15 vendime**, prej të cilave, deri në momentin e raportimit, gjykata ka vendosur në mbështetje të vendimeve të marra nga ILDKPKI, **për 14 vendime**, duke shfuqizuar vetëm një numër të pakonsiderueshëm vendimesh me sanksion “gjobë”.

Njëkohësisht janë marrë masa nëpërmjet organeve përbarimore për vënien në ekzekutim të vendimeve lidhur me sanksionet administrative “gjobë”, ku për vitin raportues rezulton të jenë vënë në ekzekutim **82 vendime**, prej të cilave **22 vendime, i përkasin saksioneve të vendosura përgjatë vitit 2019**. Për t’u theksuar është fakti se në **37 raste**, shlyerja e detyrimit është kryer në mënyrë vullnetare nga subjektet e sanksionuara.

Inspektorati i Lartë, vijon ndjekjen e ekzekutimit të pjesës tjetër të vendimeve pranë organeve përbarimore, si dhe njëkohësisht ndjekjen e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ, për çështjet e ankimuara.

#### - Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të kapaciteteve njerëzore, në funksion të misionit të institucionit.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka përmbushur detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe Kodit të Punës për punonjësit mbështetës. Nëpërmjet Njësisë Përgjegjëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni, si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre, në përputhje me afatet ligjore brenda periudhës 6 mujore.



Për vitin 2019, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante për 7 (shtatë) vende për pozicione në kategorinë ekzekutive, 2 (dy) vende për pozicione në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, si dhe 5 (pesë) vende për pozicione në kategorinë e lartë drejtuese, në ILDKPKI.

**C- Zbatimi i masave specifike të dala nga rekomandimet e instrumentave ndërkombëtarë, ku Shqipëria është shtet anëtar dhe të raporteve të Komisionit Evropian.**

Inspektorati i Lartë, për shkak të përmbushjes së të gjitha rekomandimeve të lëna nga organizatat ndërkombëtare, GRECO dhe Komisioni Evropian në vitet e mëparshme, për vitin raportues nuk pasur asnjë rekomandim të paadresuar për këtë periudhë.

Inspektorati i Lartë ka vijuar punën në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve mbështetëse nga partnerët USAID dhe Këshilli i Evropës/Bashkimi Evropian, për ngritjen dhe vënien në funksionim të Sistemit Elektronik të deklarimit të interesave privatë. Ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, të cilat shfuqizuan afatet 3 - 5 vjeçare në drejtim të vënies në funksionim të Sistemit Elektronik, u vlerësuan nga Komisioni Evropian në Raportin për Shqipërinë 2019, si një ndër arritjet nën prioritetin e tretë “Lufta kundër korrupsionit”.

Në këtë kuadër, me qëllim përmbushjen e angazhimeve të marra në drejtim të ngritjes dhe vënies në funksionim të Sistemit Elektronik të deklarimit të interesave privatë, u morën masat e nevojshme për planifikimin e punës për përgatitjen dhe përditësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm. Për këtë, në muajin shtator 2019 përfundoi procesi i regjistrimit të sistemit si bazë të dhënash shtetërore, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe u dakordësua përmbajtja e projekt-aktit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, i cili do t’i përcillet Ministrisë së Drejtësisë, për marrjen e iniciativës ligjore dhe miratimin e mëtejshëm nga Këshilli i Ministrave.

Në vijim të procesit të garantimit të qëndrueshmërisë së sistemit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve financiare, për të siguruar mirëmbajtjen e sistemit, si një kërkesë e domosdoshme në zbatim të VKM nr. 710/2013, u morën të gjitha masat institucionale në parashikimin dhe alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore nga buxheti i shtetit.

Ju faleminderit !

